



Biografi e shkurtër

Iva Seseri, këshilltare ligjore

Zj.Iva Seseri është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 1995. Në vitin 2014 ka përfunduar studimet “Master i Shkencave në legjislacion dhe institucionet europiane” pranë Institutit të Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune prej rreth 23 vitesh, me angazhime profesionale në institucione të ndryshme publike dhe private.

Në vitin 1997 ka filluar punë si juriste pranë Qendrës Kombëtare të Kinematografisë. Për periudhën 1999 - 2009 ka qenë përgjegjëse e Zyrës Juridike në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.

Prej korrikut 2011 deri në mars 2014 ka punuar si specialiste në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë, në Gjykatën Kushtetuese.

Nga prilli i vitit 2014 deri në qershor 2021 ka punuar si këshilltare në Shërbimin Juridik të Kuvendit të Shqipërisë, pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Ka marrë pjesë në konferenca, seminare dhe trajnime, brenda dhe jashtë vendit, kryesisht në lidhje me hartimin dhe përafrimin e legjislacionit, praktikat dhe procedurat parlamentare, si dhe të drejtat e njeriut.

Zotëron gjuhën angleze, franceze dhe italiane. Nga muaji korrik 2021 znj.Seseri është këshilltare ligjore në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese.